



ANËTARËSIMI EVENTUAL I KOSOVËS NË
AGJENCITË E SPECIALIZUARA TË
KOMBEVE TË BASHKUARA:
PROCEDURAT DHE PERSPEKTIVAT



Sheshi Nënë Terezë, Hyrja I · 59A · Nr. 10
Prishtinë, 10000
Republika e Kosovës
T/F: +383 38 746 206
E-mail: ridea.institute@gmail.com
Website: www.ridea-ks.org

STUDIM:

ADERIMI EVENTUAL I KOSOVËS NË
AGJENCITË E SPECIALIZUARA TË KOMBEVE
TË BASHKUARA DHE ORGANIZATAT E
NDËRLIDHURA: PROCEDURAT DHE
PERSPEKTIVAT

Nëntor 2019

STUDIM:

ADERIMI EVENTUAL I KOSOVËS NË
AGJENCITË E SPECIALIZUARA TË KOMBEVE
TË BASHKUARA DHE ORGANIZATAT E
NDËRLIDHURA: PROCEDURAT DHE
PERSPEKTIVAT

Ky studim u mbështet nga:



Norwegian Embassy

Deklaratë mohimi: Pikëpamjet dhe analiza në këtë raport janë vetëm të RIDEA-s dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet e donatorit.

Autor: Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA)

Nëntor 2019

Përmbajtja

Shkurtesat	i
Hyrje	1
Kosova dhe anëtarësimi në OKB	2
Statusi i Përhershëm i Vëzhguesit në OKB	9
Anëtarësimi në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe Komisionin Ekonomik të OKB-së për Evropën	10
Aplikimi për anëtarësim në Agjencitë e specializuara të OKB-së: Përmbledhje	14
Agjencitë e specializuara të OKB-së me perspektivat më të mira për anëtarësimin e Kosovës	16
Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimin e Bujqësisë	16
Organizata Botërore e Shëndetësisë.....	17
Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale	19
Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin Industrial (UNIDO)	20
Agjenci të tjera të Specializuara të OKB-së: Vështirësi më të mëdha për anëtarësimin e Kosovës	21
Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë.....	22
Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil.....	22
Organizata Ndërkombëtare e Punës.....	23
Organizata Ndërkombëtare Detare.....	24
Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit	25
Unioni Postar Universal.....	26
Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara.....	27
Organizata Meteorologjike Botërore	28
Organizata Botërore e Turizmit.....	29
Organizatrat e nderlidhura me OKB-në	30
Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike.....	30
Organizata Ndërkombëtare për Migrim.....	31
Organizata Botërore e Tregtisë.....	32
Komisioni Përgatitor për Organizatën Gjithëpërfshirëse të Traktatit për Ndalimin e Testeve Nukleare	33
Organizata për Ndalimin e Armëve Kimike	34
Përfundime dhe Rekomandime	35

Shkurtesat

ANEA	Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike
BEAP	Bashkëpunimi Ekonomik Azi-Paqësor
BZHA	Banka për Zhvillimin e Azisë
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FNZHB	Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimin e Bujqësisë
GBB	Grupi i Bankës Botërore
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
KAK	Konventa e Armëve Kimike
OBM	Organizata Botërore e Meteorologjisë
OBPI	Organizata Botërore e Pronës Intelektuale
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë
OBT	Organizata Botërore e Turizmit
OÇP	Organizata Çlirimtare Palestineze
ONAC	Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil
ONAK	Organizata për Ndalimin e Armëve Kimike
OND	Organizata Ndërkombëtare Detare
ONP	Organizata Ndërkombëtare e Punës
OUB	Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë
RDGJ	Republika Demokratike Gjermane
REK	Republika e Kinës
RFGJ	Republika Federale e Gjermanisë
RPK	Republika Popullore e Kinës
UNESCO	Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara
UNIDO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin Industrial
UNT	Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit
UPU	Unioni Postar Universal

Hyrje

1. Pasi shpalli pavarësinë e saj më 17 shkurt 2008, Republika e Kosovës deri tani ka aderuar në disa organizata ndërkombëtare dhe rajonale, përfshirë Bankën Botërore, Fondin Monetar Ndërkombëtar, Gjykatën e Përhershme të Arbitrazhit, Organizatën Doganore Botërore, Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Komisionin e Venecias të Këshillit të Evropës dhe Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal, midis shumë organizatave të tjera ndërqeveritare.
2. Anëtarësimi i Kosovës në këto organizata ka sjellë përfitime të ndërsjella për Kosovën, organizatat në fjalë dhe shtetet e tyre anëtare. Anëtarësimi në këto organizata ka konfirmuar dhe konsoliduar statusin e Kosovës si një shtet sovran dhe i pavarur; gjithashtu ka kontribuar në forcimin e sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare dhe në promovimin e marrëdhënieve miqësore ndërmjet shteteve.
3. Anëtarësimi i Kosovës në Kombet e Bashkuara, organizata universale *par excellence*, ka mbetur e pakapshme. Ndërsa Kosova i plotëson në mënyrë të kënaqshme kriteret për anëtarësim në Kombet e Bashkuara, siç diskutohet më poshtë, konsideratat politike të shteteve kryesore anëtare të OKB-së kanë qenë një pengesë për anëtarësimin e Kosovës në organizatën botërore.
4. Sistemi i OKB-së është i përbërë nga vetë Kombet e Bashkuara dhe afro 17 programe, fonde dhe agjenci të specializuara, të gjitha me kërkesat dhe procedurat e tyre të anëtarësimit. Këto përfshijnë Bankën Botërore dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar, ku, siç përmendet, Kosova tashmë është anëtare e plotë, dhe Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara (UNESCO), në të cilën Kosova pretendoj anëtarësimin por që rezultoi pa sukses në vitin 2015.
5. Anëtarësimi i mëtutjeshëm në sistemin e OKB-së do të ishte me dobi të konsiderueshme për Kosovën. Ky punim do të ofrojë analizën e kërkesave të anëtarësimit të Kombeve të Bashkuara dhe organeve të tij dhe do të vlerësojë

perspektivat e aderimit të Kosovës në to. Punimi do të përfundojë me një diskutim të opsioneve dhe rekomandimeve të politikave.

Kosova dhe anëtarësimi në OKB

6. Neni 4 (1) i Kartës së OKB-së parashikon që 'anëtarësimi në Kombet e Bashkuara është i hapur për të gjithë... shtetet paqe-dashëse që pranojnë detyrimet e përfshira në këtë Kartë dhe, sipas gjykimit të Organizatës, janë të aftë dhe të gatshëm të kryejnë këto detyrime'. Neni 4 (2) më tutje thekson se pranimi i një shteti të tillë do të bëhet me rekomandim të Këshillit të Sigurimit, i ndjekur nga një vendim i Asamblesë së Përgjithshme. Pranimi i anëtarëve të rinj klasifikohet si një "pyetje e rëndësishme" në nenin 18 të Kartës dhe prandaj kërkon në Asamblesë e Përgjithshme mbështetjen e një shumicë të dy të tretave të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë, sesa një shumicë e thjeshtë.
7. Në Opinionin e saj Këshillimor të vitit 1948 *mbi Kushtet e Pranimit të një Shteti për Anëtarësimin në Kombet e Bashkuara (neni 4 i Kartës)*, Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë iu kërkua të përcaktonte nëse kriteret në nenin 4 (1) ishin shterrues, ose nëse anëtarët e Këshillit të Sigurimit dhe Asamblesë së Përgjithshme kanë mbajtur diskrecionin të vendosin kushte të mëtejshme për një aplikant për anëtarësim. Shumica e Gjykatës konstatuan se kushtet ishin shterruese dhe për këtë arsye ishte juridikisht e palejueshme për anëtarët e Këshillit të Sigurimit dhe Asamblesë së Përgjithshme të marrin parasysh faktorët politikë që nuk lidhen me kushtet e pranimit.
8. Kosova i plotëson në mënyrë të qartë kushtet shterruese për anëtarësim në OKB të listuara në nenin 4 (1). Kosova ka arritur shtetësinë. Përfaqësuesit e zgjedhur në mënyrë demokratike të popullit të saj shpallën pavarësinë e saj më 17 shkurt 2008 si përfundimi i një procesi ndërkombëtar të udhëhequr nga OKB për përcaktimin e statusit final të saj. Pavarësia e Kosovës ishte një domosdoshmëri e pashmangshme, e diktuar si nga historia e shtypjes, ashtu edhe nga shtypja brutale e shkaktuar popullit të Kosovës, përfshirë humbjen tragjike të jetës së civilëve dhe dëbimin e tyre në një shkallë masive nga shtëpitë dhe vendi i tyre, dhe nga nevoja

natyrore për të drejtën për liri dhe vetëvendosje. Në një Opinion Këshillimor të 22 korrikut 2010, GJND konkludoi se 'miratimi i deklaratës së pavarësisë së 17 shkurtit 2008 nuk shkel ligjin e përgjithshëm ndërkombëtar, rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244 (1999) ose Kornizën Kushtetuese. Si pasojë, miratimi i asaj deklarate nuk cënon asnjë rregull të zbatueshëm të së drejtës ndërkombëtare.'

9. Kosova i plotëson kriteret për shtetësi të përcaktuara me konventën e Montevideos të vitit 1933, e pranuar gjerësisht se pasqyron ato kushte të parapara në ligjin zakonor ndërkombëtar: ka një popullsi të përhershme, një territor të përcaktuar/definuar, qeveri, dhe aftësi për të hyrë në marrëdhënie me shtetet e tjera.¹ Shtetësia e Kosovës është njohur nga shumica e vendeve anëtarë të OKB-së (114 prej 193 sosh).
10. Që nga arritja e shtetësisë, Kosova ka treguar qartë se është një shtet paqe-dashës që kërkon gjithmonë të veprojë në përputhje me parimet dhe qëllimet e Kombeve të Bashkuara. Kosova jeton në paqe brenda dhe jashtë vendit, duke u përpjekur të qeverisë vetë në përputhje me parimet dhe kërkesat e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit. Kosova nuk kërcënon me forcë kundër asnjë fqinji. Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore janë të garantuara në Kushtetutën e Kosovës, dhe më tej mbështeten nga anëtarësimi i Kosovës në Komisionin e Venecias të Këshillit të Evropës. Nuk mund të dyshohet se Kosova do të jetë në gjendje dhe e gatshme të kryejë detyrimet e saj si anëtare e OKB-së. Siç u përmend më lart dhe diskutohet më poshtë në hollësi të mëtutjeshme, Kosova tashmë është anëtare e dy prej 15 agjencive të specializuara të OKB- së (Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore).
11. E drejta e Kosovës për t'u bërë anëtare e OKB-së mbështetet nga parimi i anëtarësimit universal i cili është i nënkuptuar në Kartë dhe i cili është afirmuar nga praktikat pasuese. Një e drejtë e të gjitha shteteve paqe-dashëse për anëtarësimin në OKB rrjedh nga parimi i barazisë sovrane të shteteve, një parim

¹ Konventa Montevideo për të drejtat dhe detyrat e shteteve (1933), 165 LNTS 19; 49 Stat 3097, Neni 1.e. E disponueshme: <https://www.ilsa.org/Jessup/Jessup15/Montevideo%20Convention.pdf> [Qasur më: 10 tetor 2019].

themelor zakonor i rendit juridik ndërkombëtar, i pasqyruar në nenin 2 (1) të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe konfirmuar në Deklaratën e Marrëdhënieve Miqësore të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në vitin 1970.² Duke pasur parasysh rëndësinë e OKB-së dhe Kartës së saj si një kornizë themelore për rendin ndërkombëtar juridik dhe politik, është pranuar gjerësisht që të gjitha shtetet paqe-dashëse duhet të pranohen në anëtarësim. Asambleja e Përgjithshme në vitin 1954 vuri në dukje "ndjenjën e përgjithshme në rritje në favor të universalitetit të Kombeve të Bashkuara" (AP rez 817 (IX)). Është vërejtur se gjatë periudhës nga 1966 deri më 1969, më shumë se 70 referenca për parimin e anëtarësimit universal u bënë në Asamblenë e Përgjithshme.

- 12.** Rëndësia e anëtarësimit universal në OKB mbështetet nga praktika e OKB-së. Në dekadën e parë të Kombeve të Bashkuara, tensionet e Luftës së Ftohtë panë një numër shtetesh të lidhura me secilën palë që ishin të bllokuar nga anëtarësimi në OKB si pasojë e përdormit të vetos në Këshillin e Sigurimit. Sidoqoftë, në vitin 1955-56 të gjitha këto shtete u pranuan në një 'marrëveshje në pako'. Pas kësaj dekade të hershme, shtetet e reja që dolën nga dekolonizimi ose nga shpërbërja e shteteve ekzistuese janë pranuar përgjithësisht në OKB pa kundërshtim. Në dekadat e fundit, universaliteti është arritur pothuajse plotësisht. Shtetet që fillimisht ishin përmbajtur nga kërkimi i anëtarësimit u pranuan në vitet 1990 dhe në fillim të viteve 2000, përfshirë Zvicrën dhe një numër shtetesh të vogla në Evropë dhe Paqësor.

- 13.** Përkundër faktit se Kosova i plotëson kriteret ligjore për anëtarësim në OKB dhe kështu ka të drejtë të pranohet në përputhje me parimin e universalitetit, ajo deri më tani nuk ka pranuar të bëjë kërkesë për pranim. Kjo është kryesisht për shkak të mundësisë që, në kundërshtim me detyrimet ligjore të organeve të OKB-së të marrin në konsideratë vetëm kriteret në nenin 4 të Kartës së KB (siç sqarohet në

² Asambleja e Përgjithshme e OKB, Deklarata mbi Parimet e Ligjit Ndërkombëtar në lidhje me Marrëdhëniet Miqësore dhe Bashkëpunimin midis Shteteve në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, 24 Tetor 1970, A / RES / 2625 (XXV). E disponueshme: <https://unispal.un.org/DPA/DPR/unispal.nsf/0/25A1C8E35B23161C852570C4006E50AB> [Qasur më: 11 tetor 2019].

Opinionin Këshillëdhënës të GJND-së 1948), aplikimi i Kosovës do të parandalohej nga kundërshtimi i disa shteteve të cilat nuk e njohin shtetësinë. Në veçanti, në klimën aktuale, një rezolutë e Këshillit të Sigurimit që kërkon të rekomandojë pranimin e Kosovës në përputhje me nenin 4 (2) të Kartës do t'i vihej vetoja. Në një Opinion Këshillëdhënës të 3 Marsit 1950, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë vendosi që Asambleja e Përgjithshme nuk mund të pranonte një shtet në mungesë të një rekomandimi nga Këshilli i Sigurimit.

- 14.** Praktika e OKB-së sugjeron që një shtet i ri ka të ngjarë të pranohet pasi shtetësia e tij të jetë njohur nga sovrani i mëparshëm ose nga ndonjë shtet rival që pretendon sovranitet mbi të njëjtin territor. Për shembull, pranimi i 'shteteve të ndara' të Luftës së Ftohtë u vonua derisa të dyja qeveritë ranë dakord të njohin njëri-tjetrin (në rastin e Gjermanisë dhe Koresë) ose derisa njëra qeveri të ketë arritur të bashkojë tërë territorin (në rastin e Vietnamit). Në rastin e Gjermanisë, asnjë shtet gjerman nuk ishte anëtar i OKB-së për disa dekada. Republika Demokratike Gjermane (RDGJ) aplikoi për pranim në vitin 1966 por aplikimi i saj nuk përparoi më tej për shkak të kundërshtimit të shteteve perëndimore, duke reflektuar politikën e Republikës Federale të Gjermanisë (RFGJ) se vetëm ajo ishte përfaqësuesi legjitim i të gjithë Gjermanisë. Pas një ndryshimi të qeverisë në RFGJ, pozicioni i saj u zhvendos dhe në 1972 RFGJ dhe RDGJ njohën shtetësinë e njëri-tjetrit. Të dy shtetet u pranuan në OKB në vitin 1973. Në mënyrë të ngjashme, as Republika e Koresë dhe as Republika Popullore Demokratike e Koresë nuk ishin anëtare të OKB-së deri në vitin 1991, kur pas një marrëveshjeje midis të dy shteteve ato u pranuan njëkohësisht.
- 15.** Një problem i mbetur ligjor që rrjedh nga fenomeni i Luftës së Ftohtë të "shteteve të ndara" është statusi i Republikës së Kinës (Tajvanit). Megjithëse qeveria e ReK humbi kontrollin mbi territorin qeveritar ndaj qeverisë së Republikës Popullore të Kinës në vitin 1949 dhe u dëbua në ishullin e Tajvanit, ajo vazhdoi të përfaqësonte Kinën në OKB deri më 1971, kur Asambleja e Përgjithshme miratoi Rezolutën 2758 (me 76 vota për, 35 kundër, dhe 17 abstenime) për të dëbuar delegacionin e REK nga OKB dhe për ta zëvendësuar atë me delegacionin e RPK. Gjatë kësaj periudhe, të dy qeveritë ndanë qëndrimin se ekzistonte vetëm një shtet

kinez: mosmarrëveshja ishte se cila qeveri ishte përfaqësuesesja e ligjshme e shtetit. Në dekadat e fundit, përdërisa Tajvani nuk e ka braktisur zyrtarisht këtë pozitë se ekziston vetëm 'një Kinë' dhe ka pretenduar një shtetësi të veçantë, Tajvani është larguar prej kësaj ideje në praktikë dhe ka kërkuar anëtarësim të veçantë në OKB në 1993-95 dhe më vonë në 2007. Megjithatë, kundërshtimi i fortë i RPK-së dhe pranimi i doktrinës 'një Kinë' nga shumica e anëtarëve të OKB-së, do të thotë që aplikimet e Tajvanit nuk janë konsideruar kurrë zyrtarisht. Meqenëse nuk ka ndonjë perspektivë të parashikueshme që kundërshtimi i RPK-së ndaj anëtarësimit të Tajvanit në OKB do të zhvendoset, Tajvani ka kërkuar të marrë pjesë në organizatat ndihmëse dhe përkatëse të OKB-së, megjithëse me relativisht pak sukses. Përkundër këtyre pengesave, Tajvani vazhdon të ndjek anëtarësimin ose pjesëmarrjen në institucionet ndërkombëtare dhe mban një rekord suksesi në organizata zyrtare globale dhe rajonale siç janë Organizata Botërore e Tregtisë (OBT) dhe Banka për Zhvillimin e Azisë (BZHA) dhe forume të tjera ndërkombëtare si Bashkëpunimi Ekonomik Azi-Paqësor (BEAP).

16. Gjatë periudhës së dekolonizimit, ish kolonitë pothuajse gjithmonë pranoheshin në OKB me pëlqimin e, dhe pas njohjes nga, ish-pushteti kolonial. Një rast pjesërisht i jashtëzakonshëm ishte Guinea-Bissau, ku në vitet 1960 dhe 1970 një lëvizje e pavarësisë (PAIGC) luftoi një luftë të gjatë kundër Portugalisë, fuqisë koloniale. Në vitin 1973, ndërsa lufta ishte ende duke vazhduar, PAIGC shpalli pavarësinë e Republikës së Guinea-Bissau, e cila u njoh nga rreth 40 shtete. Asambleja e Përgjithshme në nëntor 1973 miratoi një rezolutë (rezolutë 3061 (XXVIII)) 'duke përshëndetur pranimin e fundit të pavarësisë së popullit të Guinea-Bissau, duke krijuar kështu shtetin sovran të Guinea-Bissau '. Në prill të vitit 1974, regjimi Portugez u përmbys në 'Revolucionin Karafil 'dhe qeveria e re ra dakord për armëpushim dhe hyri në negociata me PAIGC. Më 12 gusht 1974, pranimi i Guinea-Bissau në OKB u rekomandua njëzëri nga Këshilli i Sigurimit, por marrëveshja me Portugalinë për të njohur shtetësinë e Guinea-Bissau u lidh vetëm më 28 gusht 1974. Guinea-Bissau u pranua më pas në OKB nga Asambleja e Përgjithshme më 17 Shtator 1974. Kështu, Këshilli i Sigurimit rekomandoi pranimin e Guinea-Bissau para se Portugalia të kishte njohur shtetësinë e saj, megjithëse njohja nga Portugalia ishte qartë e pashmangshme në këtë fazë. Kjo

pasqyron qëndrimin fuqimisht negativ të marrë nga kjo pikë ndaj kolonializmit nga bashkësia ndërkombëtare.

- 17.** Bangladeshi përbën një shembull të kundërt nga e njëjta periudhë kohore e shkëputjes jashtë kontekstit kolonial. Bangladeshi, me ndihmën e ndërhyrjes ushtarake indiane, kishte arritur pavarësi efektive nga Pakistani deri në fund të vitit 1971, dhe deri në Gusht 1972 ishte njohur nga 86 shtete. Sidoqoftë, aplikimit të Bangladeshit për pranim në OKB iu vu vetoja nga Kina në Këshillin e Sigurimit në gusht 1972, megjithëse Asambleja e Përgjithshme miratoi një rezolutë në nëntor 1972 duke njohur aftësinë e Bangladeshit dhe duke kërkuar pranimin e tij (rezoluta 2937 (XXVII)). Pas një rritje të mëtejshme të numrit të shteteve që e njohën atë, Bangladeshi u njoh përfundimisht nga Pakistani më 2 shkurt 1974, pas së cilës u pranua në OKB në shtator 1974.
- 18.** Një model i ngjashëm mund të vërehet në periudhën pas Luftës së Ftohtë. Në rastet e shkëputjes nga një shtet ekzistues, anëtarët e rinj të OKB-së janë pranuar vetëm pas pëlqimit dhe njohjes së 'shtetit amë'. Për shembull, shtetet baltike u pranuan në OKB pas njohjes së pavarësisë së tyre nga Bashkimi Sovjetik në Shtator 1991, dhe republikat e tjera Sovjetike u pranuan me mbështetjen e Federatës Ruse, pasi ishte shteti që ka vazhduar personalitetin juridik të Bashkimit Sovjetik.
- 19.** Për dallim nga rastet e Bangladeshit dhe ish-Republikave Sovjetike, që përfshinin shkëputjen nga një shtet amë që vazhdoi të ekzistonte, shpërbërja e Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë përfshinte situatën juridikisht të veçantë të shpërbërjes së plotë të shtetit ekzistues më parë. (Pretendimi i Republikës Federale të Jugosllavisë për të vazhduar personalitetin juridik të RSFJ-së ishte refuzuar nga Komisioni i Badinterit dhe nga vetë OKB-ja, dhe u braktis në vitin 2000). Ky dallim midis shpërbërjes dhe shkëputjes ndihmon në shpjegimin se pse Sllovenia, Kroacia dhe Bosnje-Hercegovina u pranuan në OKB në maj 1992, përpara se RFJ t'i kishte njohur zyrtarisht ato. Një faktor tjetër është që RFJ-ja tashmë kishte deklaruar në prill 1992 gatishmërinë e saj për të njohur shtetësinë e republikave të tjera pas bisedimeve të mëtejshme dhe kishte miratuar një kushtetutë të re duke përjashtuar republikat e tjera nga fushëveprimi i saj.

- 20.** Kjo përmbledhje tregon se, përderisa Kosova ka një çështje të fortë juridike se ka të drejtë të pranohet në OKB, megjithatë nuk ka gjasa të kapërcejë pengesën e vetos së Këshillit të Sigurimit përderisa Serbia ende refuzon ta njohë atë. Shtetet e mëparshme në një pozitë të krahasueshme, përfshirë Guinea-Bissau dhe Bangladeshin, kanë përfituar një rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme duke e njohur qartë shtetësinë e tyre. Megjithëse një rezolutë e tillë nuk mundet pa Këshillin e Sigurimit t'i pranojë ato në OKB, por rezoluta e forcoi pretendimin e tyre për shtetësi, inkurajoi shtetet tjera t'i njohin ato, dhe kështu i bëri presion shtetit 'amë' për ta njohur pavarësinë e tyre, duke ndihmuar në hapjen e rrugës për pranim. Sidoqoftë, Kosova duhet të jetë e kujdesshme në ndjekjen e këtij optionsi. Serbia ose shtetet e tjera që nuk e njohin Kosovën mund të pretendojnë se njohja e shtetësisë së Kosovës do të ketë një efekt negativ në paqen dhe sigurinë ndërkombëtare dhe kështu do të binte në kategorinë e 'rekomandimeve në lidhje me ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare', e cila sipas nenit 18 të Kartës së OKB-së klasifikohet si një 'pyetje e rëndësishme' për të cilën kërkohet një shumicë prej dy të tretave. Aktualisht 114 nga 193 shtetet anëtare të OKB-së (59%) e kanë njohur Kosovën. Edhe nëse ky lexim do të refuzohej dhe një shumicë e thjeshtë do të mjaftonte për të miratuar rezolutën, një votim i ngushtë do të bënte më shumë dëm sesa mirë duke tërhequr vëmendjen për kundërshtimin e vazhdueshëm substancial të shtetësisë së Kosovës.
- 21.** Duke pasur parasysh pengesat aktuale politike për anëtarësimin e Kosovës në OKB, pjesa tjetër e këtij punimi do të diskutojë mundësitë e tjera që Kosova të marrë pjesë në sistemin e OKB-së. Së pari, do të diskutojë shkurtimisht nëse Kosova mund të njihet nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së si një shtet vëzhgues jo anëtar (si Selia e Shenjtë dhe Palestina). Së dyti, do të diskutojë (gjithashtu shkurtimisht) mundësitë e tjera që Kosova të marrë pjesë në organet e OKB-së, përfshirë Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe Komisionin Ekonomik për Evropën. Së treti, do të marrë në konsideratë proceset e pranimit në agjencitë e specializuara të OKB-së dhe agjencitë e tjera të ndërlidhura, dhe perspektivat e Kosovës për pranim në këto agjenci nëse ajo aplikon.

Statusi i Përhershëm i Vëzhguesit në OKB

22. Gjatë viteve të ekzistencës së OKB-së, disa shtete jo-anëtare, si dhe një numër organizatash ndërkombëtare dhe (gjatë periudhës së dekolonizimit) lëvizjeve nacionalçlirimtare, u janë dhënë të drejta të kufizuara të pjesëmarrjes në Asamblesë të Përgjithshme të OKB-së dhe në komitetet e saj si vëzhgues të përhershëm. Koncepti i një vëzhguesi të përhershëm nuk përmendet në Kartë dhe bazohet më tepër në praktikën pasuese. Aktualisht, Protokoli i OKB-së dhe Shërbimi Ndërlidhës rendisin dy shtete si 'Shtetet jo-anëtare që kanë marrë një ftesë të përhershme për të marrë pjesë si vëzhgues në seancat dhe punën e Asamblesë të Përgjithshme dhe mbajtjen e zyrave të përhershme në Selinë Qendrore': Selia e Shenjtë dhe Shteti i Palestinës.
23. Në vitet e para të OKB-së, Sekretari i Përgjithshëm vendosi nëse do t'iu nënshtrohej kërkesave për statusin e vëzhguesit nga vendet jo-anëtare. Shtetet e pranuar si vëzhguese mbi këtë bazë përfshinin Republikën Federale të Gjermanisë dhe Republikën e Vietnamit (në vitin 1952), Republikën Demokratike Gjermane (në 1972) dhe Republikën Demokratike të Vietnamit (në 1975). Në praktikën e fundit, vendimet merren nga Asambleja e Përgjithshme. Selia e Shenjtë u bë një vëzhguese e përhershme në Kombet e Bashkuara në vitin 1964, pas miratimit nga Sekretari i Përgjithshëm të kërkesës së saj për të marrë pjesë në punën e Asamblesë të Përgjithshme. Selia e Shenjtë ishte një vëzhgues i përhershëm mbi këtë bazë për disa dekada, derisa Asambleja e Përgjithshme miratoi (pa votim) një rezolutë në vitin 2003 që konfirmonte statusin e Selisë së Shenjtë si një vëzhgues i përhershëm dhe të drejtën e saj për të marrë pjesë në seancat dhe punën e Asamblesë 58/314). Selia e Shenjtë nuk ka pranuar të bëjë kërkesë për anëtarësim në OKB, në dritën e karakterit të saj *sui generis*.
24. Evoluimi i statusit të Palestinës në OKB ka qenë më kompleks. Në vitin 1974, në Rezolutën 3237 (XXIX), Asambleja e Përgjithshme, 'duke marrë parasysh universalitetin e Kombeve të Bashkuara të përcaktuara në Kartë, ftoi Organizatën Çlirimtare Palestineze për të marrë pjesë në seanca dhe në punën e Asamblesë të Përgjithshme në kapacitetin e vëzhguesit'. OÇP-së i'u dha ky status si një "entitet

vëzhgues" që përfaqësonte popullin Palestinez, jo si një shtet jo anëtar pasi që OÇP nuk pretendoi se kishte arritur shtetësinë në atë kohë. Në vitin 2011 Palestina bëri një kërkesë te Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së për pranim si një shtet anëtar i OKB-së. Duke pasur parasysh realitetin që aplikimi i saj do të votohej në Këshillin e Sigurimit, në vitin 2012 Palestina ndryshoi kursin dhe kërkoi që statusi i saj në Asamblenë e Përgjithshme të ndryshohet nga "entiteti vëzhgues" në "shtet vëzhgues jo anëtar". Në rezolutën 67/19 të 29 nëntorit 2012, Asambleja e Përgjithshme vendosi t'i akordojë Palestinës këtë status, me 138 shtete që votuan për, 9 votuan kundër dhe 41 abstenuan. Ashtu si në rastet e mëparshme të Guinea-Bissau dhe Bangladeshit (diskutuar në paragrafët [16] dhe [17]), Asambleja e Përgjithshme kështu ka njohur në mënyrë të qartë shtetësinë e Palestinës.

25. Kosova potencialisht mund të kërkojë të bëhet, si Selia e Shenjtë dhe Palestina, një shtet vëzhgues i përhershëm jo-anëtar në OKB. Kjo mund të realizohet me një rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së pa rekomandimin e Këshillit të Sigurimit. Sidoqoftë, një qasje e tillë ndaj anëtarësimit në OKB nuk do të ishte politikisht e matur për Kosovën për arsyet e mëposhtme. Së pari, ndryshe nga Selia e Shenjtë, Kosova nuk pretendon statusin *sui generis* dhe nuk kërkon të kufizojë pjesëmarrjen e saj në organizatën botërore. Përkundrazi, kërkon të ushtrojë të drejtat e saj si një shtet sovran krahas 193 shteteve të tjera anëtare të OKB-së. Së dyti, ndryshe nga Palestina, Kosova nuk po kërkon përfitime taktike në një afat të shkurtër i cili mund të arrihet duke përmirësuar statusin e saj. Palestina, për shembull, gëzon të drejta të reja si një shtet jo-anëtar në OKB, duke përfshirë të drejtën për të ngritur çështje kundër Izraelit në Gjykatën Penale Ndërkombëtare në Hagë. Në vend të kësaj, Kosova po kërkon të normalizojë statusin e saj në bashkësinë ndërkombëtare. Kërkimi i statusit të vëzhguesit të shtetit jo-anëtar do të dëmtonte pretendimet e Kosovës për "shtetësi normale".

Anëtarësimi në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe Komisionin Ekonomik të OKB-së për Evropën

- 26.** Dy organe të OKB-së, në të cilat Kosova potencialisht mund të kërkojë të marrë pjesë pa u bërë një anëtar i OKB-së ose vëzhgues i përhershëm janë: 1) Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë dhe 2) Komisioni Ekonomik i OKB-së për Evropën, një komision rajonal i Këshillit Ekonomik dhe Social të OKB-së. GjND dhe Këshilli Ekonomik dhe Social janë dy nga gjashtë organet kryesore të OKB-së (së bashku me Asamblenë e Përgjithshme, Këshillin e Sigurimit, Këshillin e Kujdestarisë/Trusteeship dhe Sekretariatit e OKB-së).
- 27.** Neni 93 i Kartës së OKB-së parashikon që 1) të gjithë anëtarët e OKB-së janë palë *ipso facto* të Statutit të GjND-së dhe 2) një shtet i cili nuk është anëtar i OKB-së mund të bëhet palë e Statutit të GjND-së me vendim të Asamblesë së Përgjithshme me rekomandim të Këshillit të Sigurimit. Për shkak të mundësisë së vetos në Këshillin e Sigurimit, Kosova nuk mund të bëhet palë e Statutit të GjND-së.
- 28.** Sidoqoftë, neni 35 (2) i Statutit të GjND-së parashikon që Këshilli i Sigurimit mund të përcaktojë kushtet në të cilat Gjykata do të jetë e hapur për shtetet që nuk janë palë në Statut. Në rezolutën 9 (miratuar më 15 tetor 1946), Këshilli i Sigurimit parashikoi që GjND do të jetë e hapur për çdo shtet që nuk është palë në Statut, "me kusht që një shtet i tillë të ketë depozituar më parë tek Sekretari i Gjykatës një deklaratë me të cilën ai pranon juridiksionin e Gjykatës, në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara ... dhe merr përsipër të zbatojë në mirëbesim me vendimin ose vendimet e Gjykatës dhe të pranojë të gjitha detyrimet e një anëtari të Kombeve të Bashkuara sipas nenit 94 të Kartës"(e cila kërkon pajtimin me vendimet e GjND-së në rastet kur shteti është palë). Një deklaratë e tillë mund të jetë ose e veçantë (pranimi i juridiksionit të Gjykatës në lidhje vetëm me një mosmarrëveshje ose mosmarrëveshje të veçanta që janë ngritur) ose të përgjithshme (pranimi i juridiksionit në lidhje me të gjitha mosmarrëveshjet ose të një klase të veçantë ose klase të mosmarrëveshjeve, përfshirë ato që mund të lindin në të ardhmen).
- 29.** Në të kaluarën, deklaratat në përputhje me rezolutën 9 të Këshillit të Sigurimit janë paraqitur nga një numër shtetesh përpara se ato të bëhen anëtare të OKB-së: deklarata të veçanta nga Shqipëria (1947) dhe Italia (1953) dhe deklarata të

përgjithshme nga Kamboxhia (1952), Ceylon (1952), Republika Federale e Gjermanisë (1955, 1956, 1961, 1965 dhe 1971), Finlanda (1953 dhe 1954), Italia (1955), Japonia (1951), Laos (1952) dhe Republika e Vietnamit (1952). Kohët e fundit, Palestina në vitin 2018 depozitoi një deklaratë duke pranuar juridiksionin në lidhje me mosmarrëveshjet e përfshira në nenin 1 të Protokollit Opsional të Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike, dhe më pas ka filluar proceset gjyqësore kundër Shteteve të Bashkuara në GjND mbi këtë bazë (*Rasti i zhvendosjës së Ambasadës së SHBA-së në Jeruzalem*).

30. Pranimi i juridiksionit të GjND-së potencialisht mund të përmirësojë legjitimitetin ndërkombëtar të Kosovës, si dhe të lejojë që Kosova të fillojë veprime juridike kundër atyre shteteve që kanë pranuar juridiksionin e Gjykatës nën Klauzolën Fakultative të GjND-së ose sipas ndonjë traktati që parashikon juridiksionin e GjND-së dhe në të cilin Kosova është një palë. Do të ishte në përputhje me vendimin e mëparshëm të Kosovës, në vitin 2016, për t'u bërë një shtet anëtar i Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit.
31. Sidoqoftë, ka edhe arsye që Kosova të tregohet e kujdesshme para se të përpiqet të pranojë juridiksionin e GjND-së në këtë mënyrë. Së pari, është e paqartë nëse një deklaratë në përputhje me rezolutën 9 do të pranohej nga Sekretari/Regjistruesi i Gjykatës. Regjistruesi mund të udhëhiqet nga praktika e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, politika e të cilit është se ai nuk është në gjendje të përcaktojë, me iniciativën e tij, nëse një entitet me status të diskutueshëm është një shtet. Në raste të tilla, Sekretari i Përgjithshëm do të pranojë nënshkrimin ose ratifikimin vetëm kur një rezolutë e Asamblesë së Përgjithshme tregon që entiteti në fjalë është një shtet.³ Ndërsa shtetësia e Palestinës është njohur nga Asambleja e Përgjithshme (shiko paragrafin [24] më

³ Praktika e Sekretarit të Përgjithshëm është paraqitur në këtë dokument: https://treaties.un.org/doc/source/publications/practice/summary_english.pdf. Paragrafët [81] - [83] thonë se Sekretari i Përgjithshëm duhet të ndjekë praktikën e Asamblesë së Përgjithshme (AP) në përcaktimin nëse do të pranojë një instrument të pranimi nga një entitet, shtetësia e të cilit është diskutuar. Para [83] shprehet se praktika përkatëse e AP duhet të gjendet në indikacione pa ekuivoke nga AP që ai e konsideron një entitet të veçantë të jetë një shtet, dhe se indikacione të tilla duhet të gjenden në rezolutat e AP. Kjo sugjeron që nuk do të ishte e mjaftueshme që shumica e anëtarëve të OKB-së ta njohin Kosovën; AP do të duhet të miratojë një rezolutë që i referohet Kosovës si shtet, duke e adoptuar këtë pozicion si pikëpamjen e vetë Asamblesë së Përgjithshme, jo vetëm të disa prej anëtarëve të saj.

lart), Asambleja e Përgjithshme nuk ka miratuar (ende) një rezolutë të tillë në lidhje me Kosovën. Nga ana tjetër, sekretari mund të mendojë se çdo shqetësim në lidhje me vlefshmërinë e deklaratës do të ishte çështje që vetë Gjykata ta përcaktojë në të ardhmen. Së dyti, përfitimet praktike dhe rreziqet gjithashtu duhet të vlerësohen. Përderisa deklarata mund të lejojë që Kosova të fillojë proceset gjyqësore, ajo gjithashtu mund të lejojë që vetë Kosova të paditet. Nëse një çështje që përfshin Kosovën si palë ka ardhur në Gjykatë, Gjykata mund të detyrohet të prononcohet nëse Kosova është shtet. Ndërsa një gjykim i favorshëm për këtë pikë do të ishte një fitore e madhe për Kosovën, një gjykim negativ ose i dyshimtë do të ishte katastrofal.

32. 'Një organ tjetër i mundshëm i OKB-së në të cilin Kosova mund të kërkojë të marrë pjesë është Komisioni Ekonomik për Evropën, një komision rajonal i Këshillit Ekonomik dhe Social të OKB-së. Megjithëse anëtarësimi i plotë në Komision u është rezervuar anëtarëve të OKB-së, neni 8 i kushteve të referencës së Komisionit thotë se '[ai] Komisioni mund të pranojë në një aftësi konsultative kombet Evropiane jo anëtare të Kombeve të Bashkuara, dhe të përcaktojë kushtet në të cilat ata mund të marrin pjesë në punën e tij, përfshirë çështjen e të drejtave të votimit në organet ndihmëse të Komisionit'.⁴ Rregulli 39 i rregullores dhe procedurave të Komisionit parashikon që vendimet merren nga shumica e anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë.⁵ Meqenëse 36 nga 56 anëtarët e Komisionit (64.2%) e kanë njohur Kosovën, do të kishte perspektivë të fortë për pranim si anëtar këshillues i Komisionit. Një aplikim i suksesshëm nga Kosova do ta pasonte precedentin e Mauritanisë, e cila i'u bashkua Komisionit Ekonomik për Afrikën përpara se të bëhej anëtare e OKB-së.

⁴ UN Doc E/ECE/778/Rev.5, E disponueshme: www.unece.org/fileadmin/DAM/oes/mandate/Commission_Rev5_English.pdf. [Qasur më: 14 tetor 2019].

⁵ Ibid.

Aplikimi për anëtarësim në Agjencitë e specializuara të OKB-së: Përmbledhje

33. Nenet 57 dhe 63 të Kartës së OKB-së ofrojnë një kornizë ligjore me të cilën "agjencitë e ndryshme të specializuara ... në fushat ekonomike, sociale, kulturore, arsimore, shëndetësore dhe fusha të ngjashme" do të futen në marrëdhënie me OKB me marrëveshje të Këshillit Ekonomik Social të OKB-së, me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme. Pesëmbëdhjetë agjenci të specializuara të OKB-së kryejnë funksione të veçanta në përputhje me këto dispozita. Këto agjenci janë organizata ndërkombëtare me personalitete të veçanta juridike ndaj vetë OKB-së, por janë në koordinim të ngushtë me të dhe janë pjesë e sistemit më të zgjeruar të OKB-së. 15 agjencitë e specializuara janë:

- Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN)
- Grupi i Bankës Botërore
- Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimin e Bujqësisë (FNZHB)
- Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh)
- Organizata Botërore e Pronës Intelektuale (OBPI)
- Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin Industrial (UNIDO)
- Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë (OUB)
- Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ONAC)
- Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP)
- Organizata Ndërkombëtare Detare (OND)
- Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit (UNT)
- Unioni Universal Postar (UPU)
- Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO)
- Organizata Botërore e Meteorologjisë (OBM)
- Organizata Botërore e Turizmit

34. Secila prej këtyre organizatave ka rregullat dhe procedurat e veta për anëtarësim. Kosova tashmë është anëtare e dy prej 15 agjencive të specializuara të OKB-së,

FMN dhe Grupi i Bankës Botërore, dhe është pranuar në të dy organizatat në vitin 2009. Të dyja këto institucione administrohen nga një bord i udhëheqësve (guvernatorëve) që përfaqësojnë shtetet anëtare. Votimi në bord peshohet në përputhje me kontributet financiare të anëtarëve në organizatë. Meqenëse donatorët kryesorë të FMN-së dhe Grupit të Bankës Botërore janë shtete që e kanë njohur dhe mbështesin shtetësinë e Kosovës, rezultoi që anëtarësimi i Kosovës në këto organizata të jetë relativisht i pakomplikuar. Sikurse sigurimi i njohjeve të mëtejshme ndërkombëtare të shtetësisë së Kosovës, anëtarësimi në këto institucione kryesore financiare ndërkombëtare ka dhënë përfitime të konsiderueshme ekonomike për Kosovën.

- 35.** Që nga anëtarësimi në FMN dhe Bankën Botërore, Kosova ka provuar të bashkohet me një agjenci tjetër e lidhur me OKB-në: UNESCO. Sidoqoftë, aplikimi për t'u anëtarësuar në UNESCO ishte i pasuksesshëm. Për dallim nga FMN dhe Banka Botërore, votimi me peshë nuk përdoret në UNESCO. Përkundrazi, anëtarët e rinj duhet të rekomandohen nga Bordi Ekzekutiv i UNESCO-s dhe më pas të aprovohen nga një shumicë prej dy të tretave të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë në Konferencën e Përgjithshme të UNESCO-s (për diskutim të mëtejshëm, shihni paragrafët [68] deri [72] më poshtë). Ndërsa Kosova arriti të marrë rekomandimin e Bordit Ekzekutiv të UNESCO-s, ajo dështoi në fazën e dytë në nëntor 2015. Në Konferencën e Përgjithshme të UNESCO-së, aplikimi i Kosovës mori 92 vota pro 50 kundër (me 29 abstenime), tre vota më pak se shumica e dy të tretave. Dështimi i papritur i Kosovës pasoi nga fakti se disa anëtarë që kanë njohur shtetësinë e Kosovës (përfshirë Japoninë, Republikën e Koresë, Perunë dhe Poloninë) abstenuan në vend që të votojnë pro.
- 36.** Në vlerësimin e perspektivave të Kosovës për t'u bashkuar me secilën agjenci, ky raport përmend listën e shteteve që kanë njohur shtetësinë e Kosovës, të gjetur në faqen e internetit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës. Sipas kësaj liste, 116 shtete kanë njohur Kosovën: 114 nga 193 shtetet anëtare të OKB-së, si dhe Ishujt Cook dhe Niue, vende jo-anëtare të OKB-së, të cilat janë në asociacion të lirë me Zelandën e Re. Sidoqoftë, duhet të theksohet se ka pasur raporte që disa nga

këto shtete kanë tërhequr njohjen e tyre për Kosovën, e cila nëse është e vërtetë do të sugjeronte që nuk mund të mbështetet në votat e tyre.

37. Agjencitë e specializuara, proceset e pranimit të të cilave ka shumë të ngjarë të lejojnë që Kosova të bëhet anëtare janë FNZHB, OBSH, OBPI, dhe UNIDO. Këto agjenci do të konsiderohen së pari, pasuar më pas nga agjencitë e tjera të specializuara të OKB-së.
38. Analiza e mëposhtme fokusohet pjesërisht në raportin e politikës 'Integrimi i Kosovës në Sistemin e Kombeve të Bashkuara', shkruar nga Lowell West dhe Albana Rexha e Grupit për Studime Juridike dhe Politike e botuar në maj 2018.

Agjencitë e specializuara të OKB-së me perspektivat më të mira për anëtarësimin e Kosovës

Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimin e Bujqësisë

39. Neni 3 (1) i Marrëveshjes që Themelon FNZHB⁶ thotë se çdo shtet që është anëtar i OKB-së ose i ndonjë agjencie të specializuar të tij (ose i Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike) ka të drejtë të aplikojë për anëtarësim. Si anëtar i FMN dhe Bankës Botërore, Kosova e plotëson këtë kriter të pranueshmërisë. Kërkesa tjetër është që aplikimet e reja për anëtarësim duhet të aprovohen nga Këshilli Drejtues (Neni 3 (2)), me shumicë të thjeshtë të numrit të përgjithshëm të votave (Neni 6). Ashtu si në FMN dhe Banka Botërore, votat e anëtarëve të FNZHB-së në Këshillin Drejtues peshohen nga kontributi financiar ndaj Fondit (Neni 6).
40. Ashtu si me FMN-në dhe Bankën Botërore, shumica e donatorëve kryesorë të FNZHB janë shtete që njohin dhe mbështesin Kosovën. Shtetet e Bashkuara, për shembull, janë donatori i vetëm më i madh me 7.02% të votave, pasuar nga Gjermania me 4.13%, Japonia me 4.05%, Mbretëria e Bashkuar me 3.89% dhe Franca me 3.02%. Kështu, Kosova ka të ngjarë të jetë e suksesshme në një

⁶ Marrëveshja për Krijimin e Fondit Ndërkombëtar për Zhvillimin bujqësor (1976) 15 ILM 922.

përpjekje për t'u anëtarësuar në FNZHB. FNZHB mund të sigurojë ndihmë të vlefshme për të ndihmuar zhvillimin e sektorit bujqësor në vështirësi të Kosovës. Një avantazh tjetër është se FNZHB mbledh pjesën më të madhe të fondeve përmes kontributeve vullnetare, kështu që bashkimi nuk do të impononte një detyrim të madh financiar për Kosovën.

Organizata Botërore e Shëndetësisë

41. Neni 3 i Kushtetutës së OBSH-së parashikon që anëtarësimi në OBSH është i hapur për të gjitha shtetet.⁷ Anëtarët e OKB kanë një të drejtë automatike për t'u bërë anëtare të OBSH-së (Neni. 4), ndërsa vendet jo-anëtare të OKB-së mund të pranohen si anëtarë të OBSH-së me shumicë të thjeshtë votash të Asamblesë së Shëndetit (Neni 6), ku secili shtet anëtar është i përfaqësuar në mënyrë të barabartë. Të gjitha vendet anëtare të OKB-së përveç Lihtenshtajnit janë anëtare të OBSH-së. Përveç kësaj, Ishujt Cook dhe Niue, të cilat janë shtete në asociacion të lirë me Zelandën e Re, janë anëtare të OBSH-së, por jo-anëtare të OKB-së. Nga 194 anëtarët e OBSH-së, 115 e kanë njohur Kosovën. Nëse të gjitha këto shtete do ta mbështesnin pranimin e Kosovës në një votim të Asamblesë së OBSH-së, aplikimi i Kosovës do të ishte i suksesshëm edhe nëse të gjitha shtetet jo-njohëse do të votonin kundër. Sidoqoftë, aplikimi i dështuar për t'u anëtarësuar në UNESCO tregon nevojën për veprim diplomatik për t'u siguruar që të gjitha shtetet që njohin shtetësinë e Kosovës në të vërtetë do të votonin pro pranimin të saj sesa të abstenonin. Pasiqë Ishujt Cook dhe Niue janë anëtarë të OBSH-së, pavarësisht se nuk janë shtete plotësisht sovraane, Kosova mund të argumentojë se ajo duhet të pranohet në OBSH përkundër polemikave për shtetësinë e saj. Duke pasur parasysh rëndësinë e lartë të funksioneve të OBSH-së në fushën e shëndetit publik, anëtarësimi ka të ngjarë të jetë me përfitim praktik për Kosovën, megjithëse do të duhej të paguante detyrimet e vlerësuara që reflektojnë GDP-në dhe popullsinë e saj.

⁷Kushtetuta e Organizatës Botërore të Shëndetësisë 14 UNTS 185. E disponueshme: https://www.who.int/governance/eb/who_constitution_en.pdf [Qasur më: 13 tetor 2019].

42. Sidoqoftë, përkundër dispozitave ligjore në Kushtetutën e OBSH që kërkojnë vetëm një shumicë të thjeshtë votash, praktika e OBSH-së është në përgjithësi të vendosë për pranimin e anëtarëve të rinj përmes konsensusit të të gjithë anëtarëve dhe jo me votim zyrtar. Kështu, në vitin 1989 OBSH shtyu shqyrtimin e një kërkesë nga Palestina për t'u anëtarësuar në organizatë për shkak të mungesës së konsensusit. Kjo praktikë do të paraqiste një pengesë për pranimin e Kosovës e cila potencialisht mund të kapërcehet në një nga dy mënyrat. Një grup anëtarësh ekzistues të OBSH-së mund të insistojnë që OBSH të largohet nga kjo praktikë e përgjithshme në rastin e Kosovës dhe që pyetja të hidhet në votim. Ose ata mund të përpiqen të bëjnë presion ndaj atyre shteteve që nuk e njohin Kosovën që të përmbahen nga kundërshtimi zyrtar i pranimi të saj. Kosova do të duhet të mobilizojë mbështetjen diplomatike të aleatëve të saj për të arritur këto rezultate.
43. Ka edhe shtete vëzhguese që nuk votojnë që marrin pjesë në punën e OBSH-së, megjithëse ashtu si statusi i vëzhguesit të përhershëm të OKB-së, ky status nuk ka asnjë bazë ligjore zyrtare në Kushtetutën e OBSH-së. Selia e Shenjtë merr pjesë si vëzhguese në OBSH me ftesë të Drejtorit të Përgjithshëm, duke reflektuar konsensusin e Asamblesë Botërore të Shëndetësisë (ABSJ). Përkundër praktikës së zakonshme që kërkon konsensus, Organizata Çlirimtare e Palestinës u pranua si vëzhguese më 1974 në bazë të rezolutës së ABSJ 27.37, me 77 vota pro, 1 kundër dhe 16 abstenime. Nga viti 2009 deri në vitin 2016, Tajvani ishte i ftuar nga Drejtori i Përgjithshëm i OBSH-së të merrte pjesë si vëzhgues në Asamblenë Botërore të Shëndetësisë nën emrin 'Taipei Kinez', duke reflektuar një konsensus në OBSH gjatë një periudhe marrëdhëniesh më të mira ndërmjet Kinës dhe Tajvanit. Sidoqoftë, pas një ndryshimi të qeverisë në Tajvan në vitin 2016, Kina rifilloi kundërshtimin e saj ndaj pjesëmarrjes së Tajvanit dhe Tajvani nuk është ftuar të marrë pjesë në Asamblenë Botërore të Shëndetit që nga viti 2017.

Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale

44. OBPI siguron një kornizë për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale ndërkombëtarisht. Instrumenti përbërës i OBPI është Konventa e OBPI.⁸ OBPI administron një numër të konsiderueshëm traktatesh shumëpalëshe në lidhje me pronësinë intelektuale, përfshirë Konventat e Parisit dhe Bernës. OBPI ka 192 anëtarë. Të gjithë anëtarët e OKB-së përveç Shteteve të Federale të Mikronezisë, Nauru, Palau dhe Sudanit Jugor janë anëtare të OBPI, ashtu si edhe 3 vende jo-anëtarë të OKB-së (Selia e Shenjtë, Niue dhe Ishujt Cook). Nga këta 192 anëtarë, 113 njohin shtetësinë e Kosovës.
45. Kosova ka të drejtë ligjore të bëhet anëtar i OBPI thjesht duke aderuar në Konventën OBPI. Cilido shtet i cili është anëtar i OKB-së ose një ose më shumë agjencie të specializuara të tij mund të bashkohet thjesht duke ratifikuar ose aderuar në Konventën OBPI, ndërsa shtetet e tjera duhet të fitojnë miratimin e dy të tretave të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë në Asamblenë e Përgjithshme të OBPI (Nenet 5 (2) dhe 6 (3) (d) Konventa OBPI). Kosova tashmë është anëtare e dy agjencive të specializuara të OKB-së, FMN dhe Grupi i Bankës Botërore. Kështu që ligjërisht nuk kërkohet miratim nga një shumicë e dy të tretave të Asamblesë së Përgjithshme të OBPI për t'u bashkuar (gjë që nuk do të ishte e mundshme përveç nëse një numër i madh i shteteve mosnjohëse abstenojnë). Nëse Kosova dëshiron të aderojë në Konventën e OBPI, ajo gjithashtu duhet të aderojë në një ose më shumë prej traktateve të administruara nga OBPI, të tilla si Konventat e Parisit dhe Bernës (shih Nenin 6 Konventa OBPI). Këto traktate parashikojnë që atyre mund t'u bashkohet 'çdo vend' dhe depozituesi i këtyre traktateve është Drejtori i Përgjithshëm i OBPI, i cili pritet të pranojë instrumentin e anëtarësimit të Kosovës duke pasur parasysh që Kosova përmbush kriterin ligjor për pranimin në Konventën e OBPI.
46. Megjithëse Kosova mund të anëtarësohet legalisht në OBPI në këtë mënyrë pa kërkuar miratimin e Asamblesë së Përgjithshme të OBPI, do të duhet të merret

⁸ Kushtetuta që themelon Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale 828 UNTS 3. E disponueshme: https://www.wipo.int/treaties/en/text.jsp?file_id=283854#article_1 [Qasur më 12 gusht 2019].

parasysh me kujdes nëse kjo do të ishte e vlefshme. Kjo rrugë e njëanshme e veprimit mund të shkaktojë pakënaqësi midis anëtarëve të OBPI që nuk e njohin Kosovën. Meqenëse vendimet në Asamblenë e OBPI merren me shumicën e dy të tretave të votave të hedhura (neni 6) (3) (d) Konventa e OBPI) këto shtete potencialisht do të kishin forcë të mjaftueshme numerike për të bllokuar sigurimin e çdo ndihme të OBPI për të ndihmuar Kosovën të ndërtojë regjimin e saj të pronësisë intelektuale, i cili do të ishte një nga përfitimet kryesore praktike të anëtarësimit në OBPI.

47. Asambleja e OBPI gjithashtu mund t'i japë statusin e vëzhguesit vendeve jo-anëtare, si dhe organizatave ndërkombëtare dhe OJQ-ve. Palestinës i është dhënë statusi i vëzhguesit në OBPI.

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin Industrial (UNIDO)

48. UNIDO përpiqet të promovojë zhvillimin industrial në vendet në zhvillim. Ashtu si me OBPI, anëtarët e OKB-së ose anëtarët e ndonjë prej agjencive të specializuara të OKB-së mund të pranohen në UNIDO thjesht duke depozituar një instrument të aderimit ose ratifikimit në Kushtetutën e UNIDO (Neni 3), ndërsa shtetet e tjera kanë nevojë për miratimin e Bordit të UNIDO-s dhe dy - të tretat e anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë në Konferencën e Përgjithshme të UNIDO-s.⁹ Pasi që Kosova është anëtare e FMN-së dhe Bankës Botërore, ajo hyn në kategorinë e parë.
49. Kështu, si çështje ligjore, do të ishte mjaft e thjeshtë që Kosova të anëtarësohej në UNIDO me aktin e vet, megjithëse si në rastin e anëtarësimit në OBPI në këtë mënyrë mund të shkaktojë pakënaqësi tek një pjesë e konsiderueshme e anëtarësisë në UNIDO. Në bashkimin me UNIDO me këtë rrugë, Kosova do të ndiqte rrugën e Palestinës, e cila i'u bashkua Kushtetutës së UNIDO-s në maj të vitit 2018. Meqenëse Palestina është anëtare e një agjencie të specializuar të OKB-së (në rastin e saj, UNESCO) kishte të drejtë të anëtarësohet në UNIDO duke

⁹ Kushtetuta e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin Industrial 1401 UNTS 3. E disponueshme: https://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg_no=X-9&chapter=10&clang=en [Qasur më 13 gusht 2019].

depozituar një instrument të pranimit dhe kështu automatikisht u bë anëtare e Organizatës.

50. Nëse anëtarësimi në UNIDO do të sigurojë përfitime praktike për Kosovën, kërkon një konsideratë. Një numër i konsiderueshëm i shteteve të zhvilluara janë tërhequr nga UNIDO, duke përfshirë Australinë, Belgjikën, Kanadanë, Danimarkën, Francën, Zelandën e Re, Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara. Këto tërheqje reflektojnë shqetësime për funksionimin e Organizatës, si dhe pikëpamjen se zhvillimi industrial mund të promovohet në mënyrë më efektive nga mekanizmat e tregut sesa nga politika industriale. Nga anëtarësia e mbetur në UNIDO e 170 shteteve, 93 (54.7%) e njohin Kosovën. Nëse bëhet anëtare e UNIDO-s, Kosova ka të ngjarë të izohet disi në Konferencën e Përgjithshme të UNIDO-s.
51. Kushtetuta e UNIDO-s gjithashtu parashikon statusin e vëzhguesit për ata që gëzojnë një status të tillë në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, ose ndryshe me një vendim të miratuar nga një shumicë e anëtarëve të Konferencës së Përgjithshme të pranishëm dhe që votojnë (Nenet 4, 8). Rregullorja e Procedurës së Konferencës së Përgjithshme të UNIDO tejkalon këtë dhe parashikon që jo-anëtarët e UNIDO-së që janë anëtarë të ndonjë prej agjencive të specializuara të OKB-së mund të marrin pjesë në Konferencën e UNIDO-s dhe të marrin pjesë në diskutimin e saj për çdo çështje shqetësuese të drejtpërdrejtë, por pa të drejtën e votës (Rregulla 30).¹⁰ Kosova sipas Rregullës 30 e ka këtë të drejtë automatike për të marrë pjesë në Konferencën e UNIDO-s si anëtare e FMN-së dhe Bankës Botërore. Selia e Shenjtë aktualisht ka statusin e vëzhguesit në UNIDO.

Agjenci të tjera të Specializuara të OKB-së: Vështirësi më të mëdha për anëtarësimin e Kosovës

52. Kërkesat e pranimit për agjencitë e tjera të specializuara të OKB-së janë më të rënda se ato të diskutuara deri më tani. Në përgjithësi, anëtarësimi në këto

¹⁰ Rregullorja e Procedurës së Konferencës së Përgjithshme, E disponueshme: www.unido.org/sites/default/files/2009-11/Rules%20GC-E_0.pdf. [Qasur më: 15 tetor 2019].

organizata kërkon miratimin e një shumice të anëtarëve ekzistues të organizatës, më së shpeshti dy të tretat e anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë. Disa agjenci të specializuara lejojnë anëtarët ekzistues të OKB të anëtarësohen pa kaluar këtë proces, por Kosova si një vend jo-anëtar i OKB-së nuk bën pjesë në këtë kategori.

Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë

- 53.** Pranimi në OUB kërkon miratim me votim të Konferencës së OUB. Dy të tretat e anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë duhet të jenë pro, dhe shumica e anëtarëve të OUB duhet të jenë të pranishëm (Neni II.2, Kushtetuta e OUB).¹¹ Aktualisht OUB ka 194 anëtarë (të gjitha shtetet anëtare të OKB-së përveç Lihtenshtajnit, dhe përveç kësaj Ishujt Cook dhe Niue). Prej tyre, 115 (59.3%) e njohin Kosovën, duke mos marrë një shumicë prej dy të tretave. Duke supozuar se të gjitha shtetet që njohin Kosovën kanë votuar në favor të pranimin të saj, 22 shtete të cilat nuk e njohin Kosovën do të duhet të abstenojnë. Fakti që Kushtetuta e OUB u referohet anëtarëve si 'kombe' sesa shtete (Neni II.1) mund të inkurajojë disa anëtarë që nuk e njohin shtetësinë e Kosovës të mos kundërshtojnë pranimin e saj.

Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil

- 54.** ONAC aktualisht ka 193 anëtarë (të gjithë anëtarët e OKB përveç Lihtenshtajnit, si dhe Ishujt Cook). Ajo ka një procedurë veçanërisht të rëndë për anëtarësimin e vendeve jo-anëtarë të OKB-së: a) që kërkon një aprovim nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së; dhe b) miratimin nga katër të pestat e numrit të përgjithshëm të shteteve anëtare të përfaqësuara dhe me të drejtën e votës në Asamblesë të ONAC (Neni 93 Konventa për Aviacionin Civil Ndërkombëtar;¹² Rregulla 53 e Rregullores së Përhershme e Procedurës së Asamblesë të ONAC).¹³

¹¹Kushtetuta e Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë së Kombeve të Bashkuara, E disponueshme: www.fao.org/3/a-mp046e.pdf. [Qasur më: 15 tetor 2019].

¹²Konventa për Aviacionin Civil Ndërkombëtar, ICAO Doc 7300. E disponueshme: www.icao.int/publications/Documents/7300_cons.pdf. [Qasur më: 14 tetor 2019].

¹³ ICAO Doc 7600/6. E disponueshme: www.icao.int/publications/Documents/7600_6ed.pdf. [Qasur më: 13 tetor 2019].

55. Kosova potencialisht mund të fitojë mbështetjen e një shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, që është ajo që kërkohet nga neni 18 i Kartës së OKB-së për miratimin e vendimeve për të gjitha çështjet përveç "pyetjeve të rëndësishme" (shiko gjithashtu diskutimin në paragrafin [6] më lart). Serbia ose shtetet e tjera që nuk e njohin Kosovën mund të pretendojnë se miratimi i anëtarësimit të Kosovës në ONAC do të ketë një efekt negativ në paqen dhe sigurinë ndërkombëtare dhe kështu të bie në kategorinë e 'rekomandimeve në lidhje me ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare', për të cilën kërkohet një shumicë prej dy të tretave. Sidoqoftë, duket sikur një lexim i tensionuar i tekstit për të pretenduar se një vendim (jo rekomandim) për të aprovuar kërkesën e Kosovës për t'u anëtarësuar në ONAC do të përbënte një rekomandim në lidhje me mirëmbajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Mbështetja e një shumicë të thjeshtë në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së do të ishte e mjaftueshme për këtë lexim.
56. Megjithatë, pasi që vetëm 114 nga 193 anëtarët e ONAC e njohin Kosovën, një aplikim për Kosovën pothuajse me siguri do të rrëzohej nga kërkesa për miratim nga katër të pestat e anëtarësisë së përgjithshme në Asamblenë e ONAC.
57. Tajvani ka bërë një përpjekje të përbashkët për të marrë pjesë në ONAC, duke i kërkuar ONAC që ta ftojë atë të marrë pjesë në takimet e ONAC si vëzhgues. Sidoqoftë, për shkak të kundërshtimit të Kinës, këto kërkesa nuk kanë qenë të suksesshme dhe Tajvani ka arritur të koordinohet me ONAC vetëm përmes kanaleve indirekte.

Organizata Ndërkombëtare e Punës

58. ONP ka 187 shtete anëtare. Të gjithë anëtarët e OKB-së janë gjithashtu anëtarë të ONP-së, me përjashtim të Andorës, Butanit, Republikës Popullore Demokratike të Koresë, Lihtenshtajnit, Mikronezisë, Monakos dhe Naurus. Ishujt Cook janë gjithashtu anëtarë. Konferenca Ndërkombëtare e Punës, e cila mbledhet një herë në vit, është përgjegjëse për pranimin e vendeve të reja anëtare. Konferenca është e përbërë nga katër përfaqësues nga secili shtet anëtar: dy që përfaqësojnë

qeverinë, një që përfaqëson organizatat e punëdhënësve dhe një që përfaqëson sindikatat e punonjësve.

59. Pranimi i anëtarëve të rinj (përveç nëse ata janë tashmë anëtarë të OKB-së) duhet të miratohet nga dy të tretat e delegatëve që marrin pjesë në Konferencë, duke përfshirë dy të tretat e delegatëve të qeverisë të pranishëm dhe që votojnë (neni 1 (4), Kushtetuta e ONP-së).¹⁴ 110 nga 187 vendet anëtare të ONP-së (52.4%) e kanë njohur Kosovën. Kështu që, Kosova për të marrë mbështetje nga dy të tretat e delegatëve të qeverisë, të paktën 22 shtete të cilat nuk e njohin Kosovën do të duhet të udhëzojnë delegatët e tyre qeveritarë të abstenojnë.

Organizata Ndërkombëtare Detare

60. OND aktualisht ka 174 shtete anëtare, të gjitha janë anëtare të OKB-së, përveç Ishujve Cook. Anëtarët e OKB-së që nuk janë anëtarë të OND (jo çuditërisht, pothuajse të gjitha shtetet e bllokuara që nuk kanë dalje në det) janë Afganistani, Andora, Botsvana, Burkina Faso, Burundi, Republika e Afrikës Qendrore, Chadi, Eswatini (dikur SWasiland), Kirgistan, Laos, Lesoto, Lihtenshtajn, etj. Mali, Mikronezia, Nigeri, Maqedonia e Veriut, Ruanda, Sudani i Jugut, Taxhikistani dhe Uzbekistani.
61. Vendet jo-anëtare të OKB-së mund të bëjnë kërkesë për anëtarësim në OND përmes Sekretarit të Përgjithshëm të OND-së. Para se ato të pranohen duke aderuar në Konventën e OND-së,¹⁵ ato së pari duhet të rekomandohen nga një shumicë e thjeshtë në Këshillin e OND (i përbërë nga 40 shtete të zgjedhura për mandat dy-vjeçar në bazë të përfaqësimit rajonal dhe përfshirjes në transportin detar) dhe më pas të aprovohen nga dy të tretat e të gjithë anëtarëve në Asamblenë e OND-së, në të cilën secili anëtar ka një votë (Konventa e OND-së, Nenet 7, 15, 16 dhe 57). Një shumicë e shteteve aktualisht në Këshillin e OND-së në 2018-19 e njohin shtetësinë e Kosovës, kështu që një aplikim nga Kosova mund të aprovohet

¹⁴ Kushtetuta e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, E disponueshme: www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=1000:61:::NO:61. [Qasur më: 14 tetor 2019].

¹⁵ Konventa për Organizatën Ndërkombëtare Detare 298 UNTS 3. E disponueshme: www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=1000:61:::NO:61: [Qasur më: 14 tetor 2019].

në këtë fazë. Sidoqoftë, Kosova do të ketë më pak të ngjarë të fitojë mbështetjen e dy të tretave të anëtarëve në Asamblenë e OND-së, pasi ajo është njohur nga 103 anëtarë nga 174 sosh (59.2%). Në çdo rast, meqë Kosova është vend pa dalje në det (vend i mbyllur/rrethuar me tokë), avantazhet praktike të anëtarësitimit në OND do të ishin të kufizuara.

Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit

- 62.** UNT ka 193 shtete anëtare: të gjithë anëtarët e OKB-së përveç Palau, si dhe Qyteti i Vatikanit. Pranimi i vendeve jo-anëtare të OKB-së në UNT duhet të aprovohet nga dy të tretat e vendeve anëtare, duke përjashtuar ato që abstenojnë (Neni 2, Kushtetuta dhe Konventa e UND;¹⁶ Rregulla 21, Rregullat e Përgjithshme të Konferencave, Asambleve dhe Takimeve të Unionit).¹⁷ Ky aprovim mund të jepet në një konferencë të plotëfuqishme që përfaqëson shtetet anëtare, e cila mbahet një herë në katër vjet, më së fundmi më 2018 (Neni 8). Nëse një kërkesë për anëtarësim bëhet në intervalin kohor midis dy konferencave të plotëfuqishme, Sekretari i Përgjithshëm i UNT-së do të konsultohet me shtetet anëtare të Unionit; një shtet anëtar konsiderohet se ka abstenuar nëse nuk është përgjigjur brenda katër muajve pasi të jetë kërkuar mendimi i tij (Neni 2). Meqenëse konferenca e ardhshme e plotëfuqishme nuk do të mbahet deri në vitin 2022, kjo është procedura që do të ndiqej nëse Kosova do të aplikonte në të ardhmen e afërt.
- 63.** 113 nga 193 anëtarët e UNT-së (58.5%) e kanë njohur shtetësinë e Kosovës. Kështu, nëse të gjitha shtetet që kanë njohur Kosovën do të mbështesin kërkesën e saj për anëtarësim, 24 shtete të tjera që nuk e njohin do të duhet të abstenojnë që aplikimi të ketë sukses. Dikush mund të spekulojë se anëtarët që priren për secilën nga pikëpamjet do të kenë më shumë të ngjarë të abstenojnë aty ku votimi bëhet me korrespondencë sesa duke u zhvilluar në një konferencë. Nëse kjo është e saktë, ajo mund ta bëjë rezultatin më të paparashikueshëm.

¹⁶Kushtetuta dhe Konventa e Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit të miratuar nga Konferenca e plotëfuqishme e vitit 2018. E disponueshme:

www.itu.int/en/history/Pages/ConstitutionAndConvention.aspx. [Qasur më: 15 tetor 2019].

¹⁷ UNT 'Rregullat e përgjithshme të konferencave, asambleve, dhe takimeve të unionit'. E disponueshme: www.itu.int/council/pd/generalrules.html. [Qasur më: 15 tetor 2019].

64. Megjithëse Kosova nuk është anëtare e UNT-së, UNT i dha asaj një kod tre-shifror për thirrje (+383) në vitin 2016. Kjo ishte në përputhje me një marrëveshje me Serbinë në shtator 2013 si pjesë e dialogut politik të udhëhequr nga BE ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit.

Unioni Postar Universal

65. Shtetet jo-anëtare të OKB-së mund të bëjnë kërkesë për anëtarësim në UPU përmes një deklarate zyrtare të aderimit në Kushtetutë dhe në aktet e detyrueshme të Unionit, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm. Drejtori i Përgjithshëm përcjell kërkesën për pranim të të gjithë anëtarët e UPU-së. Shteti aplikues do të pranohet nëse aplikimi i tij miratohet nga të paktën dy të tretat e vendeve anëtare. Vendet anëtare që nuk i janë përgjigjur brenda një periudhe prej katër muajsh konsiderohet se kanë abstenuar (neni 11, Kushtetuta e UPU).¹⁸
66. UPU ka 192 anëtarë. Të gjitha vendet anëtare të OKB-së përveç Andorës, Ishujt Marshall, Mikronezia dhe Palau janë anëtare. Qyteti i Vatikanit është gjithashtu anëtar, ashtu si dhe dy grupe terrioresh jo-sovrane: vendet përbërëse jashtë shtetit të Mbretërisë së Holandës (Aruba, Curaçao dhe Sint Maarten) dhe territoret e jashtme të Mbretërisë së Bashkuar. Secili grup i territoreve të varura përfaqësohet si kolektiv nga një anëtar. Palestina ka pasur statusin e vëzhguesit që nga viti 1999. Shtetet e Bashkuara, një anëtare ekzistuese e UPU-së, vitin e kaluar dha njoftimin për qëllimin e saj për t'u tërhequr nga UPU efektivisht nga tetori 2019 si protestë për tarifën e 'padrejta' postare ndërkombëtare.
67. Nga 192 anëtarët e tanishëm të UPU-së, 112 (58.3%) e kanë njohur shtetësinë e Kosovës (duke supozuar se territoret e jashtme holandeze dhe britanike kanë të njëjtin mendim si Holanda dhe Britania e Madhe). Nëse të gjithë 112 shtetet do të përgjigjeshin në favor të një aplikimi nga Kosova, të paktën 24 shtete të cilat nuk e njohin shtetësinë e Kosovës do të duhet të abstenojnë. Fakti që anëtarësimi ekzistues i UPU nuk është i kufizuar në shtetet sovraane mund të bëjë që disa prej

¹⁸ Kushtetuta e Unionit Postar Universal (e amendamentuar), E disponueshme: www.upu.int/uploads/tx_sbdownloader/actInThreeVolumesConstitutionAndGeneralRegulationsEn.pdf [Qasur më: 13 tetor 2019].

këtyre shteteve të jenë më të gatshëm të abstenojnë. Ashtu si në rastin e UNT, fakti që votimi zhvillohet me korrespondencë mund t'i bëjë anëtarët në përgjithësi më të predispozuar të abstenojnë, duke rritur paparashikueshmërinë e rezultatit.

Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara

- 68.** UNESCO ka 193 anëtarë. Të gjitha vendet anëtare të OKB-së janë anëtare me përjashtim të Lihtenshtajnit, Izraelit dhe Shteteve të Bashkuara. Dy shtetet e fundit më parë ishin anëtare, por u tërhoqën në vitin 2018, duke pretenduar se organizata ka një paragjykim anti-Izrael. Tre shtete jo-anëtare të OKB-së janë anëtare të UNESCO-s: Ishujt Cook, Niue dhe Palestina, i cili u pranua në UNESCO më 2011.
- 69.** Pranimi i shteteve jo-anëtare të OKB-së kërkon dy hapa (shih Nenin 2 në Kushtetutën e UNESCO-s).¹⁹ Së pari, aplikanti duhet të rekomandohet nga Bordi Ekzekutiv i UNESCO-s. Bordi është i përbërë nga 58 shtete anëtare të zgjedhur me mandat katër vjeçar nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s. Takimet e Bordit kërkojnë një kuorum të shumicës së anëtarëve të UNESCO-s dhe vendimet merren me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë (Rregullat 27 dhe 50, Rregullorja e Punës e Bordit Ekzekutiv).²⁰ Pasi të jetë marrë rekomandimi, pranimi duhet të aprovohet nga një shumicë prej dy të tretave të vendeve anëtare të pranishëm dhe që votojnë në Konferencën e Përgjithshme të UNESCO-s. Kuorumi është një shumicë e shteteve anëtare që marrin pjesë në seancën e Konferencës së Përgjithshme (shih Rregullat 62 dhe 85, Rregullorja e Procedurës së Konferencës së Përgjithshme).²¹
- 70.** Siç u diskutua më lartë, Kosova aplikoi pa sukses për pranimin në UNESCO në vitin 2015. Kjo kërkesë u aprovua nga Bordi Ekzekutiv (me 27 vota pro, 14 kundër, dhe 17 abstenime ose jo të pranishëm), por kishte më pak se një shumicë të dy të

¹⁹ Kushtetuta e Organizatës së Kombeve të Bashkuara Arsimore, Shkencore dhe Kulturore. E disponueshme: http://www.unesco.org/education/pdf/UNESCO_E.PDF. [Qasur më: 12 tetor 2019].

²⁰Rregullorja e punës e Bordit Ekzekutiv, E disponueshme: unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000366759/PDF/366759eng.pdf.multi. [Qasur më: 12 tetor 2019].

²¹Rregullorja e Procedurës së Konferencës së Përgjithshme, E disponueshme: unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000261751.page=22. [Qasur më: 13 tetor 2019].

tretave në Konferencën e Përgjithshme, duke marrë 92 vota pro 50 kundër dhe 29 abstenime.

71. Aktualisht, vetëm 26 nga 58 shtetet në Bordin Ekzekutiv të UNESCO-s e kanë njohur Kosovën. Kështu që nuk ka gjasa që Bordi të rekomandojë kërkesën e Kosovës për anëtarësim. (Serbia është gjithashtu një anëtare e bordit aktualisht dhe do të kundërshtonte me forcë pranimin, megjithëse afati i saj skadon këtë vit). Nëse Kosova do të merrte miratimin e Bordit, përsëri do të ballafaqohej me një luftë domethënëse në Konferencën e Përgjithshme: 114 shtete anëtare njohin shtetësinë e Kosovës nga gjithsej 193 (59.1%), dukshëm më pak se dy të tretat. Nëse të gjitha shtetet njohëse votojnë për pranimin e Kosovës, 22 shtete mosnjohëse do të duhet të abstenojnë që Kosova të ketë sukses. Më tej, siç u diskutua më lart, përpjekja e vitit 2015 tregon se disa shtete që njohin shtetësinë e Kosovës mund të zgjedhin të abstenojnë sesa të votojnë për pranimin e saj.
72. Rregulla 6 e Rregullores së Punës të Konferencës së Përgjithshme të UNESCO-s gjithashtu parashikon që Bordi Ekzekutiv të vendosë, përpara çdo seance të Konferencës së Përgjithshme, mbi një listë të shteteve jo-anëtare në UNESCO, të cilat duhet të ftohen të dërgojnë vëzhgues në Konferencë. Ky vendim kërkon shumicën e dy të tretave të anëtarëve të Bordit Ekzekutiv. Këto shtete vëzhgues mund të bëjnë deklaratë me gojë në takime plenare dhe takime të komiteteve, komisioneve dhe organeve të tjera ndihmëse (rregulli 66). Selia e Shenjtë është i vetmi shtet jo-anëtar, i cili aktualisht ka statusin e një vëzhguesi të përhershëm.

Organizata Meteorologjike Botërore

73. Neni 3 (c) i Konventës së OMB parashikon që çdo shtet jo-anëtar i OKB-së "plotësisht përgjegjës për vendosjen dhe kryerjen e marrëdhënieve të tij ndërkombëtare dhe pasjen e një shërbimi meteorologjik" mund të pranohet në OMB duke aderuar në Konventën OMB-së pas miratimit të pranimin të tij nga dy të tretat e shteteve anëtare.²² Vendimet e anëtarësimit bëhen me shumicën e dy të

²² Konventa e Organizatës Botërore Meteorologjike. E disponueshme: library.wmo.int/pmb_ged/wmo_15-2015_en.pdf. [Qasur më: 14 tetor 2019].

tretave të votave të hedhura për dhe kundër në Kongresin e OMB-së, ku secili shtet anëtar ka një votë (Neni 11). (Territoret e varura me shërbimin e tyre meteorologjik gjithashtu mund të bashkohen me OMB-në, por ata nuk kanë një votë në Kongresin e OMB-së për aplikimet e anëtarësimit dhe për pyetje të tjera të rëndësishme: Neni 11).

74. Aktualisht OMB ka 187 shtete anëtare. Tetë shtete anëtarë të OKB-së nuk janë anëtarë të OMB-së: Guinea Ekuatoriale, Grenada, Lihtenshtajni, Ishujt Marshall, Palau, Saint Kitts dhe Nevis, Saint Vincent dhe Grenadines, dhe San Marino. Nga vendet jo-anëtare të OKB-së, Ishujt Cook dhe Niue janë anëtare të OMB-së. 110 nga 187 vendet anëtare të OMB (58.8%) e njohin Kosovën, përsëri më pak se një shumicë prej dy të tretave.

Organizata Botërore e Turizmit

75. Anëtarësia e Organizatës Botërore të Turizmit është e hapur për të gjitha shtetet sovranë. Aplikimet duhet të aprovohen nga një shumicë prej dy të tretave të anëtarëve të plotë (d.m.th., anëtarët që janë shtete dhe jo territore të varura) të pranishëm dhe që votojnë në Asamblenë e Përgjithshme të Organizatës, me kusht që kjo gjithashtu të përbëjnë një shumicë (absolute) të të gjithë anëtarëve të plotë të Organizatës (Neni. 5, Statuti i Organizatës).²³
76. Organizata ka një anëtarësi më të vogël se shumica e agjencive të tjera të specializuara të OKB-së, me 158 shtete anëtare. (Selisë së Shenjtë dhe Palestinës i janë dhënë statusi i vëzhguesit të përhershëm nga Kuvendi). Një numër i rëndësishëm shtetesh që e njohin shtetësinë e Kosovës nuk janë anëtare, përfshirë Australinë, Belgjikën, Kanadanë, Zelandën e Re, Mbretërinë e Bashkuar dhe SHBA për shkak të konsideratave buxhetore dhe mosmarrëveshjeve me prioritetet e Organizatës. 78 nga 158 anëtarët aktualë (49.4%) e kanë njohur shtetësinë e Kosovës, duke e bërë Organizatën të vetmën agjenci të specializuar të OKB-së në

²³ Statuti i Organizatës Botërore të Turizmit. E disponueshme: www2.unwto.org/en/about/statutes. [Qasur më: 14 tetor 2019].

të cilën më pak se gjysma e anëtarësisë e ka njohur Kosovën. Kështuqë, çdo kërkesë e Kosovës për t'u anëtarësuar nuk ka gjasa të jetë e suksesshme.

Organizatat e ndërlidhura me OKB-në

77. Përveç agjencive të specializuara të OKB-së, ekzistojnë disa organizata të ndërlidhura që kanë një marrëveshje bashkëpunimi me OKB-në, por nuk përfshihen në kornizën zyrtare të neneve 57 dhe 63 të Kartës së OKB-së. Këto janë:
- Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike (ANEA)
 - Organizata Ndërkombëtare për Migrim(IOM)
 - Organizata Botërore e Tregtisë (OBT)
 - Komisioni Përgatitor për Organizatën Gjithëpërfshirëse të Traktatit për Ndalimin e Testeve Nukleare (CTBTO Komisioni Përgatitor)
 - Organizata për Ndalimin e Armëve Kimike (ONAK)

Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike

78. ANEA ka 171 anëtarë. Shumica e vendeve anëtare të OKB-së janë anëtare të ANEA-s. Shtete jo-anëtare përfshijnë Republikën Popullore Demokratike të Koresë, Guinea, Guinea-Bissau, Somalia, Sudani Jugor, Suriname dhe Timori Lindor, si dhe një numër shtetesh shumë të vogla. Selia e Shenjtë është një anëtar i plotë i ANEA-s.
79. Procedura e pranimit e ANEA zhvillohet në dy faza (shiko Nenin IV Statuti i ANEA): Së pari, një aplikim duhet të rekomandohet nga Bordi i Guvernatorëve, i përbërë nga 35 përfaqësues të shtetit të zgjedhur nga Konferenca e Përgjithshme e të gjithë anëtarëve.²⁴Aktualisht, shumica e anëtarëve të Bordit e njohin Kosovën (Serbia është gjithashtu në Bord dhe me sa duket do të kundërshtonte çdo kërkesë të Kosovës për t'u anëtarësuar në ANEA). Një shumicë e thjeshtë e anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë është gjithçka që kërkohet, por dy të tretat e anëtarëve të Bordit duhet të marrin pjesë në një mbledhje për të përbërë një kuorum. Kështu

²⁴ Statuti i Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike, E disponueshme: www.iaea.org/about/statute. [Qasur më: 15 tetor 2019].

që 6 shtete mosnjohëse do të duhej të ishin të gatshëm të marrin pjesë në një takim me kërkesën e Kosovës për anëtarësim në rendin e ditës që votimi të shkojë përpara.

- 80.** Faza e dytë e procesit të pranimit kërkon miratimin nga një shumicë e thjeshtë e anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë në Konferencën e Përgjithshme të ANEA. Një shumicë e anëtarësisë totale duhet të jetë e pranishme për të përbërë një kuorum. Një shumicë e anëtarësimit në ANEA - 96 nga 171 anëtarët aktualë (56.1%) - e njeh Kosovën. Kështu, një aplikim për anëtarësim mund të ketë sukses nëse mbërrin në këtë fazë, duke supozuar se Kosova mund të mobilizojë me sukses të gjitha ato shtete që e njohin shtetësinë e saj për të votuar për të.

Organizata Ndërkombëtare për Migrim

- 81.** Pranimi në IOM është i hapur për shtetet "me një interes të demonstruar në parimin e lëvizjes së lirë të personave", të cilët marrin përsipër të japin një kontribut financiar në kërkesat administrative të Organizatës (Neni 2, Kushtetuta e IOM).²⁵ Pranimi duhet të miratohet me një shumicë prej dy të tretave të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë në Këshillin e IOM, në të cilin Këshill secili shtet anëtar ka një votë. Organizata ka 173 shtete anëtare, të gjitha janë anëtare të OKB-së përveç Selisë së Shenjtë. Këshilli gjithashtu mund të pranojë shtetet jo anëtare si vëzhgues që nuk votojnë me një shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë (Nenet 8, 24). Tetë anëtarë të OKB-së marrin pjesë në IOM si vëzhgues: Bahreini, Butani, Indonezia, Kuvajti, Katari, Federata Ruse, San Marino dhe Arabia Saudite. Një numër i shteteve nuk janë as anëtarë dhe as vëzhgues, përfshirë Barbados, Brunei, Republikën Popullore Demokratike të Koresë, Libanin, Irakun, Malajzinë, Omanin, Sirinë dhe Emiratet e Bashkuara Arabe, si dhe disa shtete të tjera shumë të vogla.
- 82.** Kosova është njohur prej 100 nga 173 anëtarët e IOM (57.8%). Nëse të gjitha këto shtete do të votonin për të pranuar Kosovën, 23 shtete shtesë që nuk njohin do të

²⁵ Kushtetuta e Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin. E disponueshme: www.iom.int/constitution. [Qasur më 15 tetor 2019].

duhet të abstenojnë që aplikimi i Kosovës të jetë i suksesshëm. Kosova mund të përmbushë më lehtë kërkesën për shumicën e thjeshtë të votave për statusin e shtetit vëzhgues nëse kjo do të konsiderohej si një arritje mjaft e vlefshme.

Organizata Botërore e Tregtisë

- 83.** Anëtarësimi në Organizatën Botërore të Tregtisë është një proces kompleks dhe zakonisht i gjatë që përfshin ekzaminimin e regjimit tregtar të aplikantit nga një palë pune e OBT-së dhe përfshin një seri bisedimesh paralele dypalëshe ndërmjet aplikuesit dhe anëtarëve ekzistues për të negociuar kushtet e pranimit. Procesi eventualisht çon në përfundimin e kushteve të pranimit, të cilat duhet të miratohen nga një shumicë prej dy të tretave të të gjithë anëtarëve të OBT-së (Neni XII, Marrëveshja e Marrakeshit).²⁶ Sidoqoftë, nga praktika e gjatë, vendimmarrja në OBT është pothuajse gjithmonë me konsensus sesa me votim zyrtar.
- 84.** Anëtarësimi në OBT nuk është i kufizuar vetëm për shtetet sovraane por është i hapur edhe për territoret autonome doganore. Kështu, për shembull, Hong Kongu ka një anëtarësi të veçantë të OBT-së nga ajo e Kinës, dhe Tajvani është gjithashtu një anëtar nën përcaktimin 'Territori i veçantë Doganor i Tajvanit, Penghu, Kinmen dhe Matsu (Taipei kinez).' Fakti që shtetet jo-sovraane mund të anëtarësohen në OBT mund të minimizoj dhe shpërndaj kundërshtimin e anëtarësimit të Kosovës nga ata anëtarë që nuk e njohin shtetësinë e Kosovës. Sidoqoftë, praktika e OBT-së që vendimet duhet të merren me konsensus mund të irritojë çdo aplikim nga Kosova nëse disa anëtarë refuzojnë të pranojnë aplikimin. Për shembull, Irani nuk ishte në gjendje të iniciojë një kërkesë nga 1996 deri më 2005 për shkak të kundërshtimit të fortë nga Shtetet e Bashkuara që parandalonte arritjen e një konsensusi.
- 85.** Duke pasur parasysh kompleksitetin e përfshirë në negociatat e anëtarësimit në OBT, dhe faktin që shumica e tregtisë së Kosovës tashmë është e mbuluar nga Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore dhe Marrëveshja e Stabilizim-

²⁶ Marrëveshja e Marrakesh për krijimin e Organizatës Botërore të Tregtisë. E disponueshme www.wto.org/english/docs_e/legal_e/04-wto_e.htm. [Qasur më: 13 tetor 2019].

Asociimit ndërmjet BE-së dhe Kosovës, Kosova mund të kërkojë statusin e vëzhguesit në OBT si një alternativë për të ndjekur menjëherë anëtarësimin. Statusi i vëzhguesit mund t'i jepet një shteti për pesë vjet, pas së cilës një shtet pritet të vendosë nëse do të ndjekë anëtarësimin në OBT. Selisë së Shenjtë i është dhënë një status i veçantë si vëzhgues i përhershëm.

86. Sidoqoftë, një aplikim nga Kosova për statusin e vëzhguesit do të duhet të pranohet nga Këshilli i Përgjithshëm i OBT-së, dhe si me anëtarësim të plotë, konventa e vendimmarrjes së OBT-së me konsensus do të lejonte që ajo të bllokohej nga një pakicë e caktuar e anëtarëve. Për shembull, Palestina ka shprehur interes për të marrë pjesë në OBT dhe ka marrë pjesë në Konferencën Ministrore të OBT-së si një vëzhguese *ad hoc* por përpjekjet e saj për të arritur statusin e vëzhguesit zyrtar janë shterruar nga mungesa e konsensusit. Përkrahësit e Palestinës në OBT nuk janë ndjerë të aftë ose të gatshëm të largohen nga qasja tradicionale e bazuar në konsensus dhe ta vendosin çështjen në një votim.

Komisioni Përgatitor për Organizatën Gjithëpërfshirëse të Traktatit për Ndalimin e Testeve Nukleare

87. Traktati Gjithëpërfshirës i Ndalimit të Testeve Bërthamore (CTBT) parashikon një ndalim të plotë të të gjitha shpërthimeve bërthamore dhe krijimin e një organizate, CTBTO, për të monitoruar dhe verifikuar pajtueshmërinë me traktatin.²⁷ Traktati ka 168 palë, por ende nuk është në fuqi. Kjo për shkak se traktati kërkon 44 shtete të specifikuar 'aneksi 2' për të ratifikuar traktatin përpara se ai të hyjë në fuqi, dhe 8 nga këto shtete nuk e kanë ratifikuar traktatin.. Para hyrjes së traktatit në fuqi, të gjitha shtetet që kanë nënshkruar traktatin (edhe nëse nuk e kanë ratifikuar traktatin) janë anëtarë të Komisionit Përgatitor të CTBTO. Funkcionet e Komisionit Përgatitor janë të promovojnë nënshkrimin dhe ratifikimin e traktatit në mënyrë që ai të hyjë në fuqi sa më shpejt të jetë e mundur dhe të përgatisë një regjim verifikimi në ndërkohë.

²⁷ Traktati Gjithëpërfshirës për Ndalimin e Testeve Nukleare, E disponueshme www.ctbto.org/the-treaty/treaty-text/. [Qasur më: 12 tetor 2019].

88. Anëtarësimi në Komisionin Përgatitor të CTBTO nuk kërkon një votë të anëtarëve ekzistues por përkundrazi vijon automatikisht nga nënshkrimi i Traktatit. Neni XI i Traktatit parashikon që Traktati është i hapur për "të gjitha shtetet" për nënshkrim para hyrjes në fuqi të tij. Sidoqoftë, depozituesi i traktatit është Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së i cili do të krijonte një pengesë që Kosova të nënshkruajë traktatin. Siç u diskutua tashmë, politika zyrtare e Sekretarit të Përgjithshëm është që ai nuk është në gjendje të përcaktojë, me iniciativën e tij, nëse një entitet me status të diskutueshëm është një shtet. Në raste të tilla, Sekretari i Përgjithshëm do të pranojë nënshkrimin ose ratifikimin vetëm kur një rezolutë e Asamblesë së Përgjithshme tregon që njësia ekonomike në fjalë është një shtet. Aftësia e Kosovës për të nënshkruar ose ratifikuar CTBT kërkon kështu një rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së duke e njohur atë si shtet. Mundësitë për të marrë një rezolutë të tillë u diskutuan në paragrafin [20], më lart.

Organizata për Ndalimin e Armëve Kimike

89. Për dallim nga CTBT, Konventa e Armëve Kimike (KAK) është në fuqi dhe ka 193 palë shtetërore (të gjitha vendet anëtare të OKB-së përveç Izraelit, Egjiptit, Republikës Popullore Demokratike të Koresë dhe Sudanit të Jugut, dhe përveç kësaj Selinë e Shenjtë, Cook Ishujt, Niue dhe Palestina).²⁸ KAK krijon Organizatën për Ndalimin e Armëve Kimike (ONAK) si organi zbatues i Konventës. Të gjitha Shtetet Palë në Konventë janë anëtare të Organizatës, kështu që një shtet bëhet anëtar i ONAK thjesht duke aderuar në Konventë pa u kërkuar vota e anëtarëve ekzistues. Çdo shtet mund të aderojë në Konventë (neni XX). Sidoqoftë, pasi Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së është depozituesi i traktatit, e njëjta pengesë vlen si në rastin e CTBT. Sekretari i Përgjithshëm nuk do të jetë në gjendje të pranojë pranimin e Kosovës në traktat nëse Asambleja e Përgjithshme e OKB-së nuk miraton një rezolutë që e njeh Kosovën si shtet.

²⁸Konventa për Ndalimin e Zhvillimit, Prodhimit, Stokimit dhe Përdorimit të Armëve Kimike dhe Shkatërrimit të tyre 1975 UNTS 45. E disponueshme: <https://www.opcw.org/chemical-weapons-convention/download-convention>. [Qasur më: 14 tetor 2019].

Përfundime dhe Rekomandime

90. Suksesi në anëtarësimin në Kombet e Bashkuara dhe ndonjë prej organizatave të tjera anëtare do të përfaqësonte njohje të mëtejshme ndërkombëtare të shtetësisë së Kosovës dhe për këtë arsye duhet të ndiqet. Sidoqoftë, pasi që proceset e pranimit janë të ndryshme për Kombet e Bashkuara dhe për secilën nga agjencitë e specializuara, perspektivat e Kosovës për anëtarësim ndryshojnë. Kosova duhet të aplikojë vetëm për anëtarësim kur ka gjasa të larta të suksesit pasi dështimi do të përbënte një pengesë publike. Kosova gjithashtu duhet të vlerësojë se çfarë do të fitonte në terma praktikë nga pjesëmarrja në aktivitetet e veçanta të secilës agjenci dhe nëse përfitimet tejkalojnë koston e anëtarësimit. Anëtarësimi në disa agjenci do të sjellë përfitime më praktike sesa tek të tjerat.
91. Kosova e ka një çështje të fortë juridike pasi ka të drejtë të pranohet në OKB. Megjithatë, nuk ka të ngjarë të kapërcejë pengesën e vetos së Këshillit të Sigurimit përderisa Serbia ende refuzon ta njohë atë, veçanërisht duke marrë parasysh mbështetjen që gëzon Serbia nga Rusia (dhe në një shkallë më të vogël, Kina) në Këshillin e Sigurimit. Shtetet e mëparshme në një pozitë të krahasueshme kanë marrë një rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme duke njohur qartë shtetësinë e tyre. Megjithëse një rezolutë e tillë nuk do të mjaftonte për Kosovën për t'u pranuar në OKB (do të kërkohej një rekomandim i Këshillit të Sigurimit), do të forconte pretendimet e Kosovës për shtetësinë, do të inkurajonte shtetet shtesë për të njohur Kosovën, dhe kështu të bëjnë presion ndaj Serbisë për të njohur shtetësinë e saj. Megjithatë, kjo është një mundësi e rrezikshme, për të cilën Kosova duhet të tregohet e kujdesshme nëse vendos për ta ndjekur atë. Serbia ose shtetet e tjera që nuk e njohin Kosovën mund të pretendojnë se njohja e shtetësisë së Kosovës do të ketë një efekt negativ në paqen dhe sigurinë ndërkombëtare dhe kështu do të binte në kategorinë e 'rekomandimeve në lidhje me ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare', të cilat sipas nenit 18 të Kartës klasifikohet si një 'pyetje e rëndësishme' për të cilën kërkohet një shumicë prej dy të tretave. Edhe nëse ky lexim refuzohet dhe një shumicë e thjeshtë do të mjaftonte për të miratuar rezolutën, një votim i ngushtë mund të shkaktojë më shumë dëm sesa të mira duke

tërhequr vëmendjen për kundërshtimin e vazhdueshëm substancial ndaj shtetësisë së Kosovës.

- 92.** Statusi i vëzhguesit të shtetit jo anëtar si një alternativë për anëtarësimin nuk është një opsion i matur për Kosovën, edhe pse në shumë raste aktualisht mund të jetë opsioni i vetëm në dispozicion për çdo pjesëmarrje zyrtare në këto organe. Kërkimi i statusit të vëzhguesit të shtetit jo-anëtar do të dëmtonte pretendimet e Kosovës për "shtetësi normale".
- 93.** Anëtarësimi në dy organe të tjera të OKB-së është i mundur: në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe Komisionin Ekonomik të Evropës. Pranimi i juridiksionit të GJND-së mund të rrisë legjitimitetin ndërkombëtar të Kosovës. Megjithatë, e bartë rrezikun që Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së të pranojë nënshkrimin ose ratifikimin e Kosovës vetëm si subjekt i një afirmimi të shtetësisë së Kosovës nga Asambleja e Përgjithshme ose, më shumë me rrezikshmëri, të lërë shtetësinë e Kosovës të cenueshme ndaj një sfide nga Gjykata. Në të kundërtën, kërkimi i anëtarësimin në Komisionin Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën si anëtar këshillues do të ishte më pak i rrezikshëm pasi vendimi do të kërkonte një shumicë të anëtarëve dhe aktualisht 36 nga 56 anëtarët e Komisionit e kanë njohur Kosovën. Një aplikim i suksesshëm nga Kosova do të pasonte precedentin e Mauritanisë, e cila iu bashkua Komisionit Ekonomik për Afrikën përpara se të bëhej anëtare e OKB-së.
- 94.** Kjo analizë tregon se Kosova mund të aplikojë menjëherë për t'u bashkuar me dy organe të specializuara të OKB-së me perspektivë të mirë të suksesit: këto janë Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor (FNZHB), i cili përdor votimin në peshë, dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh), ku shumica e thjeshtë në Asamblenë Botërore të Shëndetësisë është e mjaftueshme juridikisht. Kosova gjithashtu ka të drejtë të anëtarësohet në Organizatën Botërore të Pronës Intelektuale (OBPI) dhe Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin Industrial (UNIDO) si një anëtar ekzisutes i FMN-së dhe Bankës Botërore.

95. Në të kundërtën, Kosova pothuajse me siguri nuk do të arrijë të përmbushë kërkesat për pranim në Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ONAC), të cilat janë më të rëndat krahasuar me ndonjë prej agjencive të specializuara të OKB-së. Aplikimet për cilëndo nga agjencitë e tjera të specializuara të OKB-së do të përballen me një betejë të ngushtë, duke pasur parasysh që ata kërkojnë një shumicë prej dy të tretave nga anëtarësia ekzistuese. Përderisa në secilën prej këtyre organizatave (me përjashtim të Organizatës Botërore të Turizmit) shumica e anëtarëve e njohin shtetësinë e Kosovës, në asnjërën nuk janë dy të tretat ose më shumë prej anëtarëve.
96. Është e mundur që Kosova mund të ketë sukses në aplikim në ato organizata nëse një numër i konsiderueshëm i shteteve që nuk e njohin Kosovën do të ishin të gatshëm të abstenojnë. Sidoqoftë, do të mbetet rreziku i dështimit nëse nuk do të mjaftonin këto shtete që të abstenojnë, ose anasjelltas nëse disa shtete që njohin shtetësinë e Kosovës, megjithatë vendosin të abstenojnë nga mbështetja e pranimin të Kosovës, siç ndodhi në Konferencën e Përgjithshme të UNESCO-s në vitin 2015.
97. Çdo vendim për të synuar pranimin në këto agjenci do të kërkonte një investim intensiv të burimeve diplomatike për të rritur mundësinë e një rezultati të suksesshëm. Kosova do të duhet të konsiderojë me kujdes nëse ky investim do të justifikohet duke pasur parasysh përfitimet e anëtarësimit të organizatës në fjalë.
98. Në çdo rast kur aplikohet për t'u anëtarësuar në një agjenci të specializuar ose të lidhur me OKB-në, Kosova duhet të investojë burime diplomatike për të siguruar që të gjitha shtetet që njohin shtetësinë e saj votojnë në favor të pranimin të saj, në mënyrë që të shmangin përsëritjen e dështimit të vitit 2015 në Konferencën e Përgjithshme të UNESCO-s.
99. Kosova do të rrisë perspektivat e saj për anëtarësim në Kombet e Bashkuara dhe agjencitë e saj të specializuara nëse rrit numrin e shteteve anëtare që njohin shtetësinë e saj. Për sa i përket Kombeve të Bashkuara, më shumë njohje do të rrisin mundësinë e një pritjeje të favorshme të Këshillit të Sigurimit dhe do ta

afrojnë Asamblenë e Përgjithshme pranë shumicës së dy të tretave të kërkuara për anëtarësim. Vështirësia mbetet përdorimi i mundshëm i vetos së Kinës dhe Ruisë, i cili mund të tejkalohet vetëm kur të tejkalohen kundërshtimet e Serbisë.

- 100.** Normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës që çon në njohje të ndërsjellë do të lehtësojë në masë të madhe njohjen e shteteve anëtare të OKB-së për Kosovën dhe do të zhbllokojë shumicën nëse jo të gjitha dyert e anëtarësimit në Kombet e Bashkuara dhe agjencitë e saj të specializuara. Shtetet mosnjohëse janë të prirura ta shohin çështjen e Kosovës si një rast të shkëputjes "jo konsensuale", pavarësisht rrethanave unike që kanë shkaktuar shtetësinë e Kosovës. Dhe siç kanë bërë shtetet në të kaluarën, ato do të marrin sugjerimet e tyre nga shteti "amë", në këtë rast Serbia. Bashkimi Evropian duhet të punojë më energjikisht për të promovuar normalizimin midis Serbisë dhe Kosovës, dhe për të siguruar që normalizimi është një kërkesë për pranimin e Serbisë në Bashkimin Evropian.

